



Pranuar / Dorezuar Prijeto / Predato Received / Delivery	30.11.2023	3	viti god year
Organ / Organizata Org / Organizat	Pr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
SAMBASHIC	7144/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1350/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malësore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti, anëtarë; me Rushit Kajtazi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1350/2023, të datës 30.10.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1350/2023, e datës 30.10.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje referuar ankuesi), më datë 30.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1350/2023, me pretendimin që t’i njihet drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive për muajt paraprak lidhur me pozitën e punës Zyrtar Certifikues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë pranë Komunës së Podujevës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale referuar kësaj çështje administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1350/2023, të datës 30.10.2023; Akt Emërimit e datës 01.06.2013 të ankuesit; Kërkesën e datës 23.01.2023 të ankuesit drejtuar Departamentit për Financa të Komunës së Podujevas; emailin e datës 07.03.202, nga ankuesi për

Urdhër pagesë nr. i zotimit 2023-454; Urdhër Pagesë nr. zotimit 2023-10975, Urdhër Obligim për pagesë të datës 18.04.2023 (e dhënat tjera të palexueshme); Urdhër Pagesë nr. zotimit 2023-21575; Urdhër Pagesë nr. zotimit 2023-19564; urdhër pagesë nr. zotimit 2023-32737; Urdhër Pagesë nr. zotimit 2023-3398; Urdhër Pagesë nr. zotimit 2023-20647, Urdhër Pagesë nr. zotimit 22331; Vendimi me numër protokolli 02-020/05-002262/23 të datës 06.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1350/2023, të datës 15.11.2023 se bashku me shkresat si: Listat e pagave për muajin tetor, nëntor, gusht, korrik, qershor, maj, mars, shkurt 2023; Marrëveshje për punë më vëllim të shtuar Nr.45951/23 të datës 30.06.2023; shkresën më titull “Konfirmim për mjete buxhetore për pagesën e kontratës për vëllim shtesë të punë; emaili i datës 03.07.2023 nga ankuesi për Diploma nr.005/11 e ankuesit; shkresë në printscreen nga profili i ankuesit në SIMBNJ; lista e ekuivalencës se koeficienteve fq ¼, dhe emaili i datës 26.10.2023 nga se bashku me emailin e datës 26.10.2023 nga Për

dhe

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Podujevës dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar më datë 01.06.2013, është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2”, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Tutje, nga provat e kësaj çështje rezulton së më Vendimin me numër protokolli 02-020/05-0002262/23, të datës 06.01.2023, të Kryetarit të Komunës së Podujevës, ankuesi është autorizuar që të kryej edhe detyrat e zyrtarit certifikues, pa afat të përcaktuar, ndërsa, me datë 30.06.2023 është lidhur marrëveshja Nr.46951/23, për punë më vëllim të shtuar, si palë nënshkruese ankuesi dhe Kryetari i Komunës së Podujevës, ku me nenin 5 të kësaj marrëveshje ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit për angazhimin lidhur me punë shtesë për pozitën “Zyrtar Certifikues”, në vlerë prej 20% të pagës bazë, për periudhën kohore nga data 30.06.2023 deri me 31.12.2023.

Ankuesi me datë 30.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Podujevës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk e ka kategorizuar ankuesin në kategorinë Drejtues i Ultë, me koeficient 7.26, duke u bazuar në Vendimin me numër protokolli 02-020/05-0002262/23, të datës 06.01.2023, të Kryetarit të Komunës së Podujevës. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën në tërësi si të bazuar, ankuesit ti njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit për pozitën e zyrtarit certifikues si dhe e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive nga data e Vendimit me numër protokolli 02-020/05-0002262/23, të datës 06.01.2023.

Lidhur me bazushmerinë e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 22 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i aplikueshëm nga data 26.09.2023, me të cilin përcaktohet se: *Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik*, si dhe nenit 37 të të njëjtit ligj me të cilin është përcaktuar : *Marrëdhënia e punës në shërbimin civil 1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji.*

Në ndërlidhje me këtë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i aplikueshëm nga data 05.02.2023), përkatësisht:

- **Nenin 2** paragrafi 1, Fushëveprimi: *Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,*
- **Neni 4**, Parimet e sistemit të pagave: *1. Sistemi i pagave i rregulluar me këtë ligj bazohet në parimet e mëposhtme: 1.1. parimi i ligjshmërisë - nënkupton se e drejta në pagë përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të autorizuara dhe të nxjerra në zbatim të tij; 1.2. parimi i transparencës – nënkupton që përcaktimi i pagës dhe të drejtave të tjera që burojnë nga paga, është informacion me interes publik dhe trajtohet në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale; 1.3. parimi i parashikueshmërisë – nënkupton se niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, mund të ulet, vetëm në bazë të ligjit; 1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit – nënkupton që secili, pa kurrëfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimi”.*
- **Neni 13**, Paga e nëpunëses/it civil: *Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”*
- **Neni 14**, Paga bazë e nëpunëses/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji. *2. Paga bazë e nëpunëses/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji. 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.*
- **Nenin 28**, Shtesa për vëllimin e punës *1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitave të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar....”.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lart, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson që nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankuesit për harmonizon e koeficientit të pagës për pozitën e Zyrtarit Certifikues, sepse, ankuesi nuk është i emëruar në këtë pozitë sipas Akt të Emërimit dhe në pajtim me procedurat e emërimit të përcaktuar me ligjin e aplikueshëm për zyrtaret publik, respektivisht, bazuar në provat materiale të parashtruara nga palat në procedurë ankuesi është i emëruar dhe mbanë pozitën e punës “Zyrtar për buxhet dhe financa” sipas Aktit të Përhershëm të Emërimit të datës 01.06.2013, ndërsa, i njëjti me vendim të Kryetarit të Komunës është autorizuar që përveç detyrave të punës se zyrtarit për buxhet dhe financa të kryej edhe detyra shtesë përkatësisht edhe detyrat e zyrtarit certifikues, duke i njohur edhe të drejtën e kompensimit për punën shtesë bazuar në marrëveshjen me shkrim të datës 30.06.2023.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1350/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Deni
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.